

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 3340 Rep.

Nr. 1026 Kol.

## AKT - THEMELIMI

I

### SHOQERISE

“ENERGO-SAS” SH.P.K.

#### Neni 1

Ne baze te ligjit Nr.7638 dt 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare”, te ligjit 7667 dtt28.01.1993 “Per regjistrimin e shoqerive ne regjistrin tregtar”, Ligjit Nr.7973, date 26.07.1995, “Per konçesionet dhe pjesemarrjen e sektorit privat ne sherbimet publike dhe infrastrukture”, VKM. Nr. 634 date 18.09.2003, Per fillimin e procedures se ndertimit me konçesion, te formes “BOO”, te Hidrocentralit te Sasaj, ne Sarande, si dhe VKM. Nr. 501, date 23.07.2004 per Miratimin e Marreveshjes se Konçesionit te formes “BOO” ndermjet Ministrise se Industrise dhe Energjitikes e Ministrise se Bujqesise dhe te Ushqimit, si Organ Shteteror i Autorizuar ( OSHA ) dhe Shoqerise “ Wonder ” Sh.a. Per ndertimin e Hidrocentralit te Sasajt.,


Sot me date 07.04.2006 para meje Noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht Zoti Vasil Gjika, ( Drejtor i Pergjitheshem dhe ortak i vetem i Wonder Sh.a. ), i biri i Nikos, i datelindjes 19.02.1955, i lindur ne Permet, banues ne Tirane, mbajtes i pasaportes nr. Z 0680788, person madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar. Ai me vullnetin e tij te lire e te plote, nepermjet ketij akti ne emer te “Wonder” Sha., themelon sot me Z. Sadik Llapashtica, i biri i Rames, i datelindjes 20.01.1960, i lindur ne Fier, banues ne Tirane, mbajtes i pasaportes nr. Z 0151776, Shoqerine konçesionare “Energo-Sas” Shpk., sipas dispozitave qe rregullojne veprimtarine e shoqerive tregtare dhe kushteve te parashikuara me poshte.

Ata deklarojne se kane nenshkruar kete kontrate dhe kane rene dakort per krijimin e Shoqerise Konçesionare “Energo- Sas” Shpk, ne baze te ketij akti themelimi si dhe statutit, duke respektuar edhe kerkesat e legjislacionit shqiptar per shoqerite tregtare.

#### Neni 2

### KRIJIMI I SHOQERISE

Qellimi i krijimit te Shoqerise Konçesionare “Energo- Sas” Shpk., eshte ushtrimi i veprimtarise konçesionare ne HEC Sasaj te Rrethit Sarande.



### Neni 3 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria "ENERGO-SAS" Shpk., ka për objekt kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe /ose pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë në baze të legjislativionit shqiptar dhe në veçanti :

Prodhimi i energjisë elektrike duke shfrytëzuar burimet e energjisë të cilat gjenden në natyrë dhe janë të rinovueshme, si ajo hidrike, diellore, e erës, gjeotermale; e biomases ose biogazit si dhe energjia nga mbetjet urbane.

Projektimi, studimi dhe ndërtimi i hidrocentraleve, termocentraleve apo impianteve të cilat bëjnë të mundur shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë nga burimet që gjenden në natyrë dhe që janë të rinovueshme, si dhe i Nënstacioneve e Linjave të Transmetimit TU dhe TL.

Promovimin e të gjithë spektrit elektro-energjitik nëpërmjet organizimit të veprimtarive të ndryshme studimore – shkencore si: seminare, sesione shkencore, konferenca, trajnime, botime, etj.

Shitja dhe blerja e energjisë elektrike klienteve, apo operatoreve të ndryshëm, privat apo shtetërorë, brenda dhe jashtë vendit. Importin dhe eksportin e saj kundrejt licensave të lejuara nga ERE, apo organe të tjera të perkatesise shtetërore.

Tregëtimin e të gjitha pjesëve, agregateve dhe pajisjeve që realizojnë prodhimin e energjisë elektrike, si dhe materialeve ndihmëse si vajra, lubrifikante, karburante, dhe derivatet e hidrokarbureve në gjendje të lenget, të ngurte apo të gazte.

Përdorimin e sistemeve të linjave, strukturave mbështetëse dhe pajisjesh, transformuese e kontrolluese për transmetimin e energjisë elektrike.

Operator i sistemit të transmetimit për të kryer aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike dhe të dispeçerimit (axhustim ose rregullimi i prodhimit të energjisë elektrike sipas kërkesave të konsumit, në nivel kombëtar).

Shpërndarjen, transportin e energjisë elektrike në sistemet shpërndarëse të tensionit, të mesëm dhe të ulët, duke patur parasysh shpërndarjen deri tek konsumatori i fundit.

### Neni 4

#### Vendodhja e selisë së Shoqërisë

Shoqëria konçesionare "ENERGO-SAS" Sh.p.k, do të ketë selinë në qytetin e Sarandës. Adresa e saj është : Rruga "Hasan Tahsini" Nr. 4, Sarandë.

### Neni 5

#### Kohezgjatja e shoqërisë "Energo-SAS" Sh.p.k

Kohezgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë Konçesionare "ENERGO-SAS" Shpk do të jetë mbi 10 vjet. Si ditë e fillimit të aktivitetit të tij do të merret data e regjistrimit në Gjykatën e Tiranës. Ortaket e shoqërisë kanë të drejtë të zgjasin këtë afat.

## Neni 6

### Ortaket Themelues

Emri i Ortakeve	Adresa e Ortakeve
1. "Wonder" Sha. perfaqesuar nga Vasil Gjika	Rruga "Ismail Qemali" Qendra e Biznesit Kati III-te, Tirane
2. Sadik Llapashtica	Rruga "Ismail Qemali" Pallati 27/1, Shkalla 1, Ap.1, Tirane

## Neni 7

### Kapitali i shoqerise "Energo-SAS" Sh.p.k

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njeqind mije) leke i ndare 100 (njeqind) kuota me vlere nominale te çdo kuote prej 1.000 (njemije) leke. Keto kuota jane nenshkruar teresisht dhe jane shlyer teresisht nga :

Nr	Emri Mbiemri	Nr Kuotave	Vlera Nominale	Kontributi ne Para
1	"Wonder"Sh.a perfaq., nga Vasil Gjika	1 - 51	1 000	51 000 leke.
2	Sadik Llapashtica	52-100	1 000	49 000 leke.

I gjithë kapitali themeltar eshte nenshkruar dhe shlyer ne te holla (leke) ne menyre te barabarte nga ortaket e shoqerise.

Ortaket themelues kanë te drejte ta zmadhojne dhe zvogelojne kapitalin e shoqerise ne para, ne perputhje me statutin e Shoqerise Konçesionare "ENERGO-SAS" Shpk Ne kete rast do te behen veprimet perkatese per pjesemarrjen e Ortakeve ne kapitalin themeltar.

## Neni 7



### Vendi i veprimtarise se Shoqerise Konçesionare "Energo-SAS" Sh.p.k

Shoqeria Konçesionare "ENERGO-SAS" Shpk., do te ushtroje aktivitetin e saj ne Hidrocentralin "SASAJ" ne Rrethin e Sarandes si dhe ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperise.

## Neni 8

### Fitimi

Fitimet qe rezultojne nga aktiviteti i shoqerise do te ndahen mbasi te jene zbritur detyrimet ndaj te treteve dhe pasi te jete lene shuma e fondit rezerve sipas percaktimit ne statut .



## Neni 9

### Asambleja e Ortakeve

Organi me i larte i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve dhe vendimet e saj. Asambleja e Zakonshme e Ortakeve thirret nje here ne vit. Kopetencat dhe pergjegjesit e Asamblese se Ortakeve percaktohen ne statutin e shoqerise .

## Neni 10

### Administratori

Drejtimi i shoqerise kryhet nga Administratori i saj qe eshte Zoti Vasil Gjika. Kompetencat, detyrat si dhe pergjegjesite e tij percaktohen ne Statutin e Shoqerise .

## Neni 11

### Pergjegjesia pesonale

Pasuria e ortakeve, administratoreve, punonjesve dhe /ose agjenteve te shoqerise eshte e perjashtuar nga çdo lloj detyrimi qe rendon mbi Shoqerine Konçesionare "ENERGO-SAS" Shpk.

## Neni 12

### Dispozitat e fundit

Te gjitha shpenzimet qe do te kryhen deri ne regjistrimin e shoqerise si person juridik do te perfshihen ne bilancin ekonomik te shoqerise.

Pjese e pandare e aktit te themelimit eshte statuti, i cili do te nenshkruhet njeherazi nga ortaket themelues.

Ortaket jane te detyruar brenda 5 diteve nga data e firmosjes te kryejne derdhjen e pjeses se kapitalit themeltar te shoqerise .

Kompetente per gjykimin e mosmarreshjeve qe lidhen me shoqerine anonime eshte Gjykata e Rrethit Tirane.

Ky akte themelimi u shkrua, lexua dhe u firmos me vullnetin e lire dhe te plote te Ortakeve themelues para noterit ne Tirane, sot me daten 07.04.2006, ne kater kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

## ORTAKET

"Wonder" Sha.,  
perfaqesuar nga  
Vasil Gjika



Sadik Llapashtica

SADIK LLAPASHTICA

